



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:283781

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05826823

KPPP.nr. 2190/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “Gurëbardhi” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811243211 dhe seli në Gremnik, Komuna e Klinës, kundër debitorit “B Corp” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810093493 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Shala, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 796/23, i lejuar me datë 24.11.2023, nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi me seli të zyrës në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 14.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “B Corp” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 810093493 dhe seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 796/23, i lejuar me datë 24.11.2023, nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori “Gurëbardhi” Sh.P.K., që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit “B Corp” Sh.P.K., shumën e përgjithshme prej EUR 208.00 (dyqind e tetë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Gurëbardhi” Sh.P.K., mbi bazën e Faturës nr. 22-SHV01-001-168, e datës 31.10.2022; Faturës nr. 22-SHV01-001-202, e datës 30.11.2022; Faturës nr. 23-SHV01-001-73, e datës 30.04.2023; Faturës nr. 23-SHV01-001-103, e datës 01.06.2023, si dhe; Faturës nr. 23-SHV01-001-156, e datës 31.07.2023, ka lejuar Urdhrit

Përmbartimor P.nr. 796/23, të datës 24.11.2023, me të cilin është detyruar debitori “B Corp” Sh.P.K., që në emër të faturave, kreditorit t’ia kompensoj shumën prej EUR 26,014.50, me kamatë ligjore nga dita e lëshimit të faturave, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se propozimi për përmbartim është i pa bazuar dhe në kundërshtim me nenin 29.3 dhe nenin 71, pika 1.6 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se kreditori asnjëherë nuk i ka dorëzuar faturat dhe se të njëjtat nuk janë parnuar, nënshkruar apo vulosur nga debitori. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të paguajë shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimin në shumë prej EUR 208.00, sipas tarifës së OAK-së, si dhe shpenzimet e tjera që do të krijohen deri në përfundim të procedurës.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të bazë ligjore, ndërsa ka shtuar se në komunikimet me debitori i njëjti nuk ka kontestuar detyrimin, ndërsa faturat i janë dërguar përmes emailit së bashku me marrëveshjet për furnizim me zhavorr për projektet e debitorit. Tutje, ka theksuar se debitori asnjëherë nuk ka kthyer as me email as fizikisht faturat e nënshkruara apo vulosur edhe pse këtë ia ka kërkuar kreditori. Në fund, ka theksuar se debitori në momentin e ngarkimi të mallit ka pranuar edhe fletë dërgesat përmes së cilave është pajtuar me sasinë dhe llojin e materialit e mbi bazën e të cilave fletë dërgesa janë lëshuar edhe faturat. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, ndërsa të obligohet debitori që kreditorit t’ia paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “Dokumenti i

*besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti, përkatësisht faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarrimor, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se faturat në fjalë janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se të njëjtat janë pranuar nga debitori, për arsye se faturave i mungon nënshkrimi apo vula e pranimi të debitorit. Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit ka pranuar faturat në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtave. Rrjedhimisht, faturat si të tilla rezultojnë të jenë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, andaj edhe nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe komunikimet elektronike të bashkëngjitura në përgjigjen në prapësim përmes së cilave kreditori ka pretenduar se faturat i janë dorëzuar debitorit, mirëpo gjen se dorëzimi i faturave në adresën elektronike të debitorit, nuk mund të konsiderohet dorëzim i rregullt përderisa sa kreditori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se faturat janë pranuar nga debitori, përkatësisht se i njëjti ka konfirmuar pranimin e email-it me përmbajtjen e faturave mbi bazën e së cilave është iniciuar procedura përmbarrimore.

Gjykata mori parasysh edhe fletë dërgesat e paraqitura nga kreditori së bashku me përgjigje në prapësim me të cilat ka pretenduar se debitori është furnizuar me mallrat objekt të faturave, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë pasi që procedura përmbarrimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal mbi bazën e të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarrimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat të LPP-së.

Megjithatë, gjykata sqaron se vendosja në këtë procedurë përmbarrimore nuk e paragjykon të drejtë e kreditorit që për pretendimet e tij ndaj debitorit të iniciojë proces të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Përfundimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilës Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin, nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarrimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit në emër të paraqitjes së prapësimit përmes përfaqësuesit të autorizuar, në vlerë prej EUR 208.00, konform rregullores në fuqi për tarifën e avokatëve.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2190/23, datë 14.06.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.